LIGJ
Nr.7681, datë 4.3.1993

PËR ADMINISTRIMIN E TATIMEVE DHE TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë, administrimi i tatimeve dhe taksave bëhet nga organet tatimore.

Organet tatimore janë Drejtoria e Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe organet e saj në komuna, bashki e rrethe që varen nga kjo drejtori.

Neni 2

Shpenzimet për mbajtjen e administratës tatimore, si dhe shpërblimet e ndryshme për të, përballohen nga buxheti i shtetit. Për këtë Drejtorisë së Tatimeve i lihet në dispozicion 0,5 për qind e të ardhurave vjetore të natyrës tatimore të parashikuara në buxhetin e shtetit.

Neni 3

Kur të ardhurat totale të buxhetit me natyrë tatimore realizohen mbi 100 për qind punonjësit e organeve tatimore shpërblehen me 10 për qind të shumës absolute të tejkalimit, por jo më shumë se 10 paga mujore në vit. Gjykimi për realizimin e të ardhurave dhe masa e shpërblimit për punonjësit e organeve tatimore në komuna, bashki e rrethe bëhet nga Drejtoria e Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, ndërsa për punonjësit e kësaj drejtorie, nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Për arkëtimin e tatimit mbi qarkullimin, si dhe akcizën për mallrat e importit, Drejtorisë së Doganave i lihet 2 për qind e shumës së arkëtuar për t'i përdorur për investime e përmirësime të ambienteve doganore.

Neni 4

Organet tatimore kryejnë të gjitha veprimet që lidhen me regjistrimin e subjekteve, mbajnë dokumentacionin përkatës, nxjerrin aktet tatimore dhe ruajnë e administrojnë dokumentacionin sipas dispozitave të veçanta.

Neni 5

Të gjitha subjektet e regjistruara në organet tatimore, pavarësisht nëse paguajnë ose jo tatime e taksa detyrohen të paraqesin në organet tatimore deklaratën parashikuese për të ardhurat dhe shpenzimet (projektprogramin financiar) vjetore brenda datës 15 nëntor të çdo viti për vitin pasardhës.

Mosparaqitja në afat e kësaj deklarate përbën shkelje të ligjit dhe dënohet me gjobë 8000 deri në 10000 lekë.

Akti tatimor nxirret në bazë të deklaratës dhe të dhënave të tjera të paraqitura nga subjektet sipas afateve të caktuara.

Organet tatimore përcaktojnë bazën, llojin dhe madhësinë e tatimeve e taksave për çdo subjekt në aktet tatimore. Asnjë organ tjetër nuk e ka këtë të drejtë.

Neni 6

Personat juridikë a fizikë, vendas dhe të huaj i nënshtrohen tatimit dhe taksave në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Neni 7

Viti tatimor përputhet me vitin kalendarik.

Neni 8

Tatimet paguhen në lekë shqiptare, përveç rasteve kur me dispozita të veçanta parashikohet ndryshe.

Për efekt të llogaritjes së tatimit, të ardhurat në valutë të huaj konvertohen në lekë shqiptare, sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në ditën e llogaritjes së tyre.

Neni 9

Në rastet kur personat fizikë a juridikë janë rezidentë të shteteve, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar konventa, për mënjanimin e tatimeve të dyfishta, ndaj tyre zbatohen dispozitat e parashikuara në këto konventa.

Drejtoria e Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, ndjek zbatimin e dispozitave të këtyre konventave dhe me autorizim të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, hyn në lidhje me autoritetet kompetente të shteteve me të cilat janë nënshkruar konventa të tilla për zgjidhjen e konflikteve që mund të lindin në këtë fushë.

Neni 10

Organet tatimore kanë të drejtë:

a. Të kontrollojnë dokumentet që vërtetojnë saktësinë e veprimeve ekonomike, llogaritjen e tatimeve dhe derdhjet e shumave përkatëse, saktësinë e deklaratave e të dhëna të tjera që lidhen me nxjerrjen e tatimeve.

b. Të kontrollojnë në vend gjendjen e lëndëve të para e ndihmëse, të prodhimeve të gatshme e të materialeve të tjera që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë ekonomike dhe realizimin e tatimeve.

c. Të kërkojnë të dhëna, njoftime e sqarime nga çdo subjekt për problemet që lidhen me tatimet dhe, kur e shohin të nevojshme, të marrin ekspertë.

Organet tatimore, për të ushtruar kontroll, paraqesin dokument identiteti.

Neni 11

Kur të ardhurat vjetore ose fitimi vjetor nuk mund të përcaktohet për shkaqe të parregullshmërisë në dokumente, ose për shkaqe të papërligjura, organi tatimor ka të drejtë të përcaktojë vetë tatimin, duke marrë për bazë:

- Dokumente me të dhëna vërtetuese;
- llojin dhe karakterin e veprimtarisë, xhiron, numrin e punonjësve, rrethin e klientelës;
- fitimin e realizuar, të ardhurat e subjekteve të tjera që ushtrojnë veprimtari të ngjashme me të.

Neni 12

Organet tatimore janë të detyruara të ruajnë fshehtësinë e të dhënave dhe të dokumenteve tatimore të tyre, si dhe të subjekteve ekonomike. Këto mund t'u jepen sipas kërkesës me shkrim vetëm organeve të drejtësisë dhe organeve të kontrollit të shtetit ose organeve e personave që përcaktohen në marrëveshjet me shtetet e tjera.

Neni 13

Agjentët e tatimeve e taksave detyrohen të kryejnë të gjitha veprimet që lidhen me mbledhjen, mbajtjen dhe evidencimin e tatimeve dhe taksave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha të ardhurat e tjera që i takojnë buxhetit të shtetit përveç të ardhurave që afatet e derdhjes janë caktuar në ligjet e veçanta tatimore, derdhen në buxhet dy herë në muaj në datat 15 dhe 28.

Mosderdhja në afatin e caktuar e të ardhurave përbën shkelje të ligjit dhe dënohet me gjobë 2000 deri 5000 lekë.

Neni 14

Agjentët e tatimeve e taksave për mosmbajtjen në rregull të dokumentacionit për evidencimin e tatimeve e taksave kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 5000 deri në 15000 lekë.

Neni 15

Për shumat e tatimit dhe të taksës të llogaritura gabim agjentët e tatimeve e taksave përgjigjen materialisht në masën e dëmit të shkaktuar.

Neni 16

Personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, pasi të kenë fituar zotësinë juridike për të vepruar, duhet të paraqesin kërkesën me shkrim për t'u regjistruar në organet tatimore.

Organet tatimore kur gjatë shqyrtimit vërejnë se kërkesa dhe dokumentet janë të rregullta, brenda 10 ditëve bënë regjistrimin dhe pajisin subjektin me çertifikatën përkatëse e cila u jep atyre të drejtën për të ushtruar veprimtari në të gjithë vendin.

Për marrjen e çertifikatës paraqiten në organet tatimore këto dokumente:

Personat fizikë vendas e të huaj

Kërkesën me shkrim ku përfshihen emri e mbiemri i plotë i tij, adresa e plotë e qendrës ku ushtron veprimtarinë, adresa e plotë e banimit, lloji i veprimtarisë që do të ushtrojë, si dhe vendimi i gjykatës që i jep zotësinë për të vepruar.

Personat juridikë vendas e të huaj

Kërkesën me shkrim ku përfshihet emri i plotë dhe i shkurtuar i tij, vendimi i gjykatës, që i jep zotësinë juridike për të vepruar, aktin e krijimit dhe kontratën e punësimit të punonjësve, si dhe autorizimin përkatës sipas ligjit nr. 7594, datë 4.8.1992 "Për investimet e huaja", kur personat janë të huaj ose kanë krijuar shoqëri me pjesmarrjen e kapitalit privat apo shtetëror vendas.

Personat juridikë vendas e të huaj i paraqesin dokumentet e mësipërme në dy kopje dhe pasi firmosen e vulosen nga organet tatimore e subjektet ekonomike, mbajnë nga një kopje secili.

Çertifikata e regjistrimit është e përshtatshme. Përsëritja e saj bëhet brenda muajit janar për personat fizikë dhe brenda muajit shkurt për personat juridikë, pa përsëritur dokumentet e regjistrimit fillestar.

Neni 17

Çdo subjekt juridik apo fizik, që ka fituar zotësinë juridike për të vepruar dhe është regjistruar në organet tatimore për të zhvilluar veprimtari ekonomiko-tregtare, detyrohet të çelë llogari rrjedhëse në bankë brenda 20 ditëve dhe t'i njoftojë organeve tatimore numrin e saj. Pas këtij afati, organet tatimore kanë të drejtën e çregjistrimit të subjektit deri në çeljen e llogarisë dhe regjistrimi fillon nga e para. Për veprimtarinë ambulante çelja e llogarisë nuk është e detyrueshme.

Neni 18

Të ardhurat e buxhetit të shtetit që rrjedhin nga tatimet e taksat, kanë përparësi në radhën e pagesave në bankë. Për detyrimet buxhetore të paderdhura në afat nga subjektet, organet tatimore kanë të drejtë të vendosin urdhërbllokimi për nxjerrjen e tyre.

Urdhërbllokimi është titull ekzekutiv për organet bankare. Kur subjekti nuk paguan tatimin në afatet e caktuara me ligj në mënyrë të përsëritur, nxirret urdhër për sekuestrimin e pasurisë deri në vlerën e detyrimit nga kryetari i degës ose zyrës së tatimeve e taksave në komuna, bashki e rrethe. Urdhëri i sekuestrimit është titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyrat e përmbarimit.

Organet tatimore, për mosderdhjen në afat të detyrimeve buxhetore e të gjobave në mënyrë të përsëritur, si dhe për parregullsi në mbajtjen e të dhënave që lidhen me tatimet e taksat, kanë të drejtën të bëjnë çrregjistrimin e subjekteve dhe t'u heqin çertifikatën përkatëse.

Të drejtën e riregjistrimit subjekti e fiton jo më parë se një muaj nga data e çregjistrimit.

Neni 19

Personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike detyrohen të mbajnë dokumentacionin dhe të nxjerrin bilancin financiar në përputhje me ligjin nr. 7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin".

Neni 20

Kur tatimi i llogaritur mbi fitimin për personat juridikë ose mbi të ardhurat për personat fizikë ka diferenca me atë të derdhur, rillogaritja e tij bëhet brenda 15 ditëve nga data e konstatimit.

Neni 21

Akti që përcakton tatimin e taksën është titull ekzekutiv.

Ankesa e ndërpret detyrimin për derdhjen e tatimeve e taksave deri në zgjidhjet përfundimtare të saj.

Neni 22

Palët e huaja në subjektet me kapital të përbashkët ose plotësisht të huaj, kur nuk u përmbahen kushteve të kontratës e ndërpresin veprimtarinë e tyre dhe transferojnë kapitale materiale e monetare, detyrohen të paraqiten brenda 5 ditëve në organet tatimore dhe të pajisen me vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj buxhetit. Organet doganore dhe ato bankare lejojnë transferimin e kapitaleve të këtyre subjekteve, vetëm kur ato janë pajisur me vërtetimin e mësipërm.

Neni 23

Organet doganore detyrohen të shënojnë në fletën e zhdoganimit të importit dhe në daljen e eksportit, numrin e çertifikatës, datën dhe vendin ku është regjistruar subjekti.

Kur subjektet nuk kanë dokumentin e mësipërm organet doganore nuk bëjnë zhdoganimin e mallit dhe njoftojnë policinë financiare të rrethit, të cilit i përket ky subjekt.

Neni 24

Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë rregullshmërinë e llogaritjes, nxjerrjes dhe derdhjes së tatimeve dhe taksave në çdo hallkë ku ato realizohen, si për mallrat e importit, ashtu edhe për ato të vendit e për taksat.

Neni 25

Për tatimet me kuotë fikse dhe për taksat, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka autoritetin të bëjë korrigjimin e tyre në vartësi të indeksit mesatar vjetor të inflacionit, një herë në vit.

Neni 26

Kur subjektet ekonomike mbyllen, shpërbëhen, ndryshojnë veprimtarinë e tyre ose pësojnë ndryshime të tjera thelbësore, organet gjyqësore detyrohen që një kopje të vendimit t'ia dërgojnë brenda 5 ditëve organeve tatimore për të bërë veprimet përkatëse.

Neni 27

Kur kryhen disa shkelje tatimore ose i njëjti person kryen disa shkelje të veçanta, merren masa për çdo shkelje.

Neni 28

Punonjësit e organeve tatimore, për veprimet që kryejnë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për tatimet e taksat, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, mbajnë përgjegjësi disiplinore sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Nuk lejohet të punojnë në të njëjtën degë apo zyrë të tatimeve e taksave, punonjës që janë ndërmjet tyre bashkëshortë, gjini e afërt ose krushqi e afërt. Gjithashtu punonjësit e organeve tatimore nuk lejohet të punësohen në sektorët privatë.

Neni 29

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka autoritetin të krijojë Komisionin e Apelimit të Tatimeve e Taksave prj 5 vetësh me specialistë nga kjo ministri dhe jashtë saj.

Ky komision shqyrton ankesat e paguesve të tatimeve dhe të taksave për mosmarrëveshjet me organet tatimore për masën e tatimeve, mënyrën e llogaritjes së tatimeve e taksave, si dhe për gjobat e vëna.

Neni 30

Të drejtën e gjobës për shkeljet e kryera nga paguesit e tatimeve e taksave sipas të gjitha ligjeve të tatimeve e taksave e kanë inspektorët dhe drejtuesit e orgneve tatimore.

Për mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet paguesve të tatimeve e taksave dhe organeve tatimore për masën dhe mënyrën e llogaritjes së tatimeve e taksave, si dhe për gjobat, paguesit e tatimeve e taksave kanë të drejtën e ankimit me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e lindjes së mosmarrëveshjeve te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki ose te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth, të cilët detyrohen të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

Kur subjekti nuk është dakord edhe me përgjigjen e dhënë, ka të drejtë që brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të ankohet te drejtori i Drejtorisë së Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, i cili i kthen përgjigje brenda 10 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

Kur subjekti nuk është dakord edhe me përgjigjen e dhënë nga drejtori i Drejtorisë së Tatimeve, ka të drejtë që brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit të ankohet te Komisioni i Apelimit të Tatimeve e Taksave, akti i të cilit është i formës së prerë.

Për mosmarrëveshjet që lindin për pagimin e taksave lokale dhe të gjobave për to, paguesit e tyre kanë të drejtën të ankohen te përgjegjësi i seksionit të financës ose ekonomik dhe kur nuk janë dakord me përgjigjen e tyre te kryetari i Bashkisë, akti i të cilit është i formës së prerë. Afatet e ankimit janë si më sipër.

Ankesa nuk shqyrtohet në rast se nuk është shqyrtuar më parë në instancat më të ulëta të dokumentuara me shkrim.

Neni 31

Dënimet e parashikuara në legjislacionin për tatimet e taksat jepen brenda 1 viti nga data e konstatimit të shkeljeve, por jo më vonë se 3 vjet nga kryerja e tyre.

Neni 32

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka autoritetin të miratojë dokumentacionin e nevojshëm dhe të nxjerrë udhëzime në zbatim të ligjeve për tatimet dhe taksat.

Neni 33

Këshilli i Ministrave, ka autoritetin të bëjë përjashtime nga pagimi i tatimeve e taksave kur ka marrëveshje qeveritare me shtetet e tjera.

Neni 34

Ligji nr.7546, datë 6.1.1992, ndryshuar me ligjin nr.7589, datë 15.7.1992 "Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë" si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.486, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.